

---

**Lënda:** Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018

**Objekti:** **Rikualifikimi Urban i dy blloqeve dhe rehabilitimi i rrugës "Dhimitër Kamarda" pjesë e Njesinë Administrative Nr 1.**

**Investitori:** **Bashkia Tiranë**

**Vlera e Investimit:** **34,871,566 lekë**

**Periudha kohore:** **Korrik 2015 deri në Janar 2017**

**Inspektimi është kryer:** **Shkurt 2019**

Ky objekt është zbatuar në zonën e njohur si zona ish-Poligrafikut, pjesë e qytetit të Tiranës, në një bllok banimi pozicionuar në një zonë me ndërtime e infrastrukturë të plotësuar shumë vite më parë (para viteve 1990), pjesë e Njesisë Administrative Nr 1. Blloku i banimit ku është investuar, kufizohet në anë Lindore dhe atë Perëndimore të rrugës "Bajo Topulli", në kufirin e Njesisë Administrative Nr 1, me një sipërfaqe të përgjithshme të këtij blloku banimi rreth 30,000 m<sup>2</sup> (sipërfaqja e shënuar përfshin ndërtesat, rrugët, sheshet, trotuaret, muret rrethuese, oborret e shtëpive e vilave, sipërfaqet e gjelberuara, etj). Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së bllokut të banimit në momentin e investimit ka qënë pjesërisht e amortizuar. Është një zonë banimi e vjetër, me ndërtime të kryera kryesisht para viteve 1990 dhe me infrastrukturë të rregulluar e sistemuar shumë vite më parë.

Projekti ka ndërhyrë në rikualifikimin urban të pjesshëm të këtij blloku banimi, duke përfshirë rikonstrukcionin e shtresave rrugore të rrugëve kryesore të zonës (shtrimin me binder dhe shtrimin me asfalt të tyre), në rehabilitimin e plotë të shtresave të dëmtuara të trupit të rrugëve të brendshme e shesheve, me te gjitha komponentet e saj (stabilizanti plus nënshtresat e tjera), në rehabilitimin e rrjetit të ujrave të bardha dhe të zeza, me rikonstrukcionin e të gjitha pusetave të ujrave të bardha e të zeza, në sistemimin e pjesshëm të trotuareve, bordurave anësore të rrugëve, në sinjalistikë rrugore, në sistemimin dhe rehabilitimin e hapësirave të lulishteve si edhe disa sheshe të vegjël që shërbejnë për parkime të jashtëm të banorëve, etj. Projekti i zbatimit ka parashikuar një rehabilitim të pjesshëm të këtij blloku banimi. Është një zonë banimi, kryesisht me pallate banimi 4 dhe 5 katëshe, si dhe ndërtime shtëpishë banimi një e dy katëshe të ndërtuara vitet e fundit, me infrastrukturë të rregulluar shumë vite më parë (para viteve 1990), por që në momentin e investimit, ka qënë e nevojshme ndërhyrja për rehabilitimin e saj, kjo edhe për shkak të amortizimit dhe kohës së gjatë pa investuar në këtë bllok banimi.

Punimet kanë filluar rreth muajit Korrik të vitit 2015, e kanë përfunduar në muajin Janar 2017, që përkon edhe me perfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Duhet të përmendim se zbatimi i punimeve për këtë bllok banimi është bërë në kushte optimale, pasi rrugët e sheshet e brendshme gjatë periudhës së rikonstrukcionit, kanë qënë kryesisht të bllokuara. Afati i garancisë së punimeve për objektin tashmë ka përfunduar (ose është në limitet e tij) dhe mendoj se investitori (bashkia Tiranë), do duhet të evidentojë në terren investimin për të parë të gjitha punimet që kanë nevojë për ndërhyrje (afati garancisë së punimeve për këtë objekt, është deri

---

në dy vjet). Edhe pse objekti ka rreth dy vjet që është përfunduar, cilësia e zerave kryesore të punimeve është poshtë nivelit mesatar (e vlerësuar kalueshëm). Edhe pse garancia e punimeve është parashikuar dy vjet prona parashikohet të ketë një jetëgjatësi të qëndrimit të saj për një periudhë nga 7 deri në 12 vite.

**Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:**

- ✓ Trupi i rrugës ka lëvizje të vogla (ulje) dhe plasaritje të shtresave të asfaltit.
- ✓ Në disa segmente ka sipërfaqe të shtresave të asfaltit, të cilat kanë filluar që të thërmohen (gjë që tregon se shtresa e asfaltit të hedhur, nuk është material cilësor dhe sipas standarteve).
- ✓ Vihen re ulje e lëvizje të pllakave të trotuareve si dhe thyerje e tyre.
- ✓ Trotuaret anësore të rrugës janë variabël (diku është 1 m diku 0.4 m, e diku vetëm bordura anësore të rrugës).
- ✓ Nuk janë respektuar sipas standartit të kërkuar lidhja e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (edhe aty ku ato janë realizuar, kanë diferencë kuotash e janë jo sipas standartit të kërkuar, ndërkohë në disa pjesë të rrugëve ato pothuajse mungojnë plotësisht).
- ✓ Ka puseta të thyera, me parete anësore të betonit të shkëputura nga pjesa metalike, apo të dëmtuara.



Fig. 1

Pavaresisht se është një investim i koheve të fundit, shtresat sipërfaqesore asfaltike kanë pësuar dëmtime të dukshme, duke nxjerrë në pah përdorimin e materialeve të cilësive se ulët në ndërtimin e tyre

- ✓ Ka diferencë të dukshme të cilësisë e markës së betonit të hedhur në kunetat anësore brenda të njejtit segment rrugor. Në një pjesë të kunetave, nuk është hequr akoma materiali i lëndës së drurit të përdorur nga firma zbatuese, për lënien e fugave të betonit për kunetat anësore të rruges. Në disa segmente rrugore kunetat anësore prej betoni mungojnë plotësisht e ato janë zvendësuar me shtresën e asfaltit.

Vihen re grumbullim të materialeve inerte (rërë+zhavor), në një pjesë të pusetave të ujrave të shiut. Pastrimi i tyre nga punonjësit e mirëmbajtjes së bashkisë nuk bëhet rregullisht duke sjellë përmbajtje e dalje të ujrave të bardha, gjatë rreshjeve të shiut.

Difektet e shfaqura në shtresat asfaltike të rrugës, trotualet anësore të saj, thyerja e kapakëve të pusetave, heqja e lëndës së drurit dhe plotësimi me fuga i të gjithë shtresave prej betoni të kunetave, do duhet detyrimisht ti ishin bërë prezent firmës zbatuese të punimeve nga specialistët përgjegjës pranë Bashkisë Tiranë, brenda afatit të plotësimit të Garancisë së Punimeve. Firma zbatuese e punimeve do duhet të ndërhynte me fondet e veta, për riparimin e menjëhershëm të defekteve të evidentuara. Vetëm pas riparimit të defekteve të shfaqura Bashkia Tiranë duhet të kryejë çbllokimin e garancisë së punimeve për këtë vepër.



Fig. 2

Në disa raste verëhen puseta të demtuara për shkak të lidhjes së papërshtatshme të materialit të puseta (hekurit) me materialin lidhes me trupin e rruges (betonin)

#### **Konkluzione në lidhje me objektin.**

- Do duhen të riparohen të gjitha uljet e shtresave të asfaltit të trupit të rrugëve dhe aty ku dukshëm asfalti rezulton i gripuar (dëmtuar) të rishtrohet e gjithë shtresa e asfaltit.
- Të bëhet riparimi i uljeve të pllakave të parapërgatitura të trotuareve, duke zvendësuar të gjitha pllakat e thyera në to.
- Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar në trotuare për lidhje të njëtrajtshme të tyre me trupin e rrugës e pa pengesa.

- *Te bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujrave të bardha e të zeza (zvendësimi i kapakëve të dëmtuar dhe betonit të dëmtuar përreth tyre).*
- *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e difekteve të verejtura mendoj se zenë me rreth 5 deri 10 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarte të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, date 13.05.2005 dhe Nr 1, date 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

**Bashkëlidhur nje foto ajërore e bllokut të banimit ku është investuar.**  
(me vijë të kuqe është kufizuar bloku i banimit ku është kryer rehabilitimi)

